



Intervistë ekskluzive për “PLISI” me Shefqet Cakolli, kryetar i SHKA “DARDANIA” në Winterthur

# Ju lumtë, jeni shtyllë e kulturës dhe integrimit

“Në SH.K.A “DARDANIA” ka anëtarë nga të gjitha trojet tona shqiptare. Pjesa më e madhe është nga Kosova, malësia (e Karadakut dhe Gollakut) mandej Prishtina, Gjilani, Kamenica, Dukagjini, Prizreni, Podujeva, Gjakova, Peja, Klina, Drenica, Kosova Lindore, (Medvegja, Bujanoci dhe Presheva) dhe Maqedonia, (Gostivar, Shkup, Tetovë), por kemi pasur edhe zvicranë që kanë ushtruar me ne një kohë të gjatë”, na tha ndër të tjera z.Cakolli



Intervistoi: Dashnim Hebibi

**S**hpesh jemi mësuar të shohim se gjërat e mira flasin vet, apo të mirës nuk kemi mundësi ti shtojmë fjalë... Një punë maratonike, një punë me përgjegjësi dhe plot elan ka bërë bashkëbiseduesi ynë prej ditës së parë në Zvicër. Ai nuk iu ndal punës për afirmim të kulturës sonë para miqve tanë zvicranë. Jemi mësuar ti shohim ambasadorët më të mirë të mundshëm të kulturës, që po rriten e edukohen jashtë atdheut

fizikisht nëpër festa të ndryshme edhe atë nëpër qytete të ndryshme të Zvicrës dhe më gjerë, ku me përkushtim mbajnë flamurin kombëtar kuq e zi, mbajnë veshjet kombëtare dhe vallëzojnë, këndojnë e recitojnë shqip. Mërgata jonë ka dhënë e po jep. Ajo nuk po ndalet, vetë e organizuar, herë me përkrahje e herë pas here pa përkrahje sa duhet, por ajo nuk ndalet, sepse në zemrat e këtyre organizimeve janë veprimtarë të dëshmuar që luftuan me forma të ndryshme, që të rinjtë dhe të rejat tona të jenë të lidhura shumë me atdheun e të mos e humbasin gjuhën amtare. Të marrësh disa fjalë nga emocionet e momentit që i shoh në skenë shqiptonjat e SHKA “DARDANIA” është e pamundur që të ikin edhe rrahjet e shpejta të zemrës dhe ndjehesh shumë krenar. Hapë bebëzat e syrit dhe ana jo verbale flet. Ajo ka gjuhën e vet, gjuhën e shpirtit dhe në fund ndjehesh krenar. Kjo krenari vjen nga paraqitja e shkëlqyeshme e këtyre shqiptonjave që janë në sofrën e madhe të kulturës

SHKA “Dardania”. Shaban Cakolli, një veprimtar i dalluar, i qetë, shihej se nuk di pushim. Në sytë e tij shihen shumë dëshira, e ato paraqiten tek bashkëbiseduesi. Ai nuk i konzervon ato, por i jep të freskëta, pa i rregulluar me ngjyra. Natyrisht, për të bashkëbiseduar me z.Cakolli, na është dashur shumë kohë, sepse ai nuk e ka për qefi të flasë në vetën e parë njëjës, por duke kuptuar profesionin tonë, ai nxorri disa fjalë zemre për tija servuar lexuesve tanë. Ai, ndër të tjera, na thotë: “Diaspora jonë, me shpirt e zemër është në atdhe, ka qenë në ditë më të vështira, por edhe do të jetë, por pret më shumë nga atdheu, që ti jepet freski veprimtarëve të shumtë që janë në diasporë”. Bashkëbisedimi ynë ishte shumë miqësor, ashtu siç janë ata që e duan kulturën, e njohin atë dhe kanë vepra. Natyrisht se ishte e pamundur të thuhesh shumë gjëra për një punë të madhe që është bërë në SHKA “Dardania” dhe kontributi i z.Cakolli në këtë shoqëri dhe vepra tjera në të mirë të atdheut.

**Z. Cakolli, fillimisht ju falënderoj për urimet e juaja për punën që kemi bërë në revistën PLISI. Padyshim, se kjo revistë është e lexuesve tanë. Na thoni drejt, po ju pëlqen emërtimi i revistës PLISI?**

**Shefqet Cakolli:** Gjithsesi se puna juaj vlerësohet me shumë respekt. Duke i përshëndetur lexuesit e PLISIT, mund të them se ky emërtim më lë shumë përshtypje, duke marr parasysh lashtësinë tonë përmes plisit që edhe sot e kësaj dite ekziston, prandaj edhe këtu në Zvicër PLISIT i dëshiroj jetë të gjatë.

**Para se të bashkëbisedojmë edhe për tema tjera, më intereson të kem një mendim tuajin se çfarë temash do të ishte më mirë të ketë kjo revistë.**

**Shefqet Cakolli:** Po mendoj se sinjeriteti dhe shtjellimi i temave pa ngjyrimë partiake, regionale e fetare, do të ishte shumë në interes të të gjithëve, duke marrë për bazë origjinalitetin dhe thjeshtësinë e të shprehurit. Shkurt thënë, pa dorëza dhe pa censurë.

**Z. Cakolli, na thuani se kur është formuar ose kur e ka filluar aktivitetin e saj SH. K.A. "Dardania"?**

**Shefqet Cakolli:** Thënë më qartë, celulat e para të aktiviteteve kulturore datojnë nga vitet e '90-ta, d.m.th koha kur filluan dyndjet tona nëpër qyte të Zvicrës. Këtu në Winterthur kemi filluar qysh në vitin '92 dhe '93, por në grupe të vogla, në strehimoret e azilkërkuessve, si në Oberwinterthur, në Hotel "Winterthur", mandej në klubin "Rugova" në Frauenfeld, dikush ishte kujtuar të merrte me vete një çifteli, dikush një sharki, dhe kështu filluan njerëzit të grumbulloheshin. Në vitin 1994 ishte një lloj bërthame e SH. K.A. "DARDANIA" të sotme, dhe pikërisht në pranverën e vitit 1995 formohet kjo shoqëri me statut dhe rregullore të saj, prej nga mund të llogaritet si shoqëri, sepse më parë ishin vetëm takime dhe iniciativa spontane. Njerëzit nuk kujtoheshin të shënonin, e mos të flasim të bënin statute e rregullore.

**Ide e kujt ka qenë që kjo shoqëri të pagëzohej me këtë emër dhe sa anëtarë kanë qenë në fillim?**

**Shefqet Cakolli:** Ide ka pasur prej të gjithëve nga pak, por me sa më kujtohet mua, si bazë dhe faktor ka qenë kënga e Gëzim Nikës "NDardani bien dy tupa", dhe atëherë ne e këndonim me pasion këtë këngë dhe ne kishim vetëm orkestrën si anëtarësi. Pra, kanë qenë diku 7 - 8 veta.

**Sa anëtarë i ka kjo shoqëri rreth vetes sot?**

**Shefqet Cakolli:** Aktualisht i ka rreth 120 anëtarë.

**Sigurisht se shoqëria është e ndarë në grupe, sa fëmijë i ka dhe sa të rritur?**

**Shefqet Cakolli:** Ashtu është. Ne i kemi tri grup-mosha. Më të vegjlit (20), të mesmit (28) dhe të rriturit 30 veta.

**Ju kujtohet paraqitja e parë para publikut dhe cili vend ka qenë dhe në çfarë**



*Kryetari i SH.K.A. "Dardania" z. Cakolli me disa nga vallëtarët e kësaj shoqërie*

**manifestimi?**

**Shefqet Cakolli:** Paraqitja e parë ka qenë për 2 korrik, në Winterthur.

**Si jeni pritur nga miqtë tanë zviceranë në atë kohë?**

**Shefqet Cakolli:** Paraqitjen e parë para zviceranëve e kemi pasur në mbrëmjen e popujve "Fata Morgana", në vjeshtën e vitit 1995, dhe ne kemi dalë shumë mirë para zviceranëve, sepse ata nuk ishin mësuar ti shohin shqiptarët duke zhvilluar kulturë. Ishte hera e parë për ta dhe prezentimi i pjesës së Rugovës të cilit i printe Sali Lajçi, tashë më i ndjerë, la aq shumë përshtypje te zviceranët, sa u mahnitën.

**Veshjet kombëtare, ku i siguron?**

**Shefqet Cakolli:** Veshjet e para i kemi marrë në Shqipëri, kurse veshjet tjera i kemi organizuar në Kosovë, Shqipëri, dhe Maqedoni, por kohëve të fundit i punojmë edhe vet.

**NJË VALLTAR OSE VALLTARE I KA DERI NË 10 PALË VESHJE**

**Prej nga financohet kjo shoqëri?**

**Shefqet Cakolli:** Shoqëria jonë, burimin kryesor financiar e ka prej anëtarësisë, sponsorimit, donatorëve, koncerteve, dasmave dhe aktiviteteve tjera në prezentimet tona. Unë shfrytëzoj rastin ti falënderoj të gjithë sponsorët tanë që janë të shumtë, dhe mund të them lirisht se janë më të koncentruarit në mesin e shoqërive, dhe kjo tregon se serioziteti ynë i ka bindur ata që fna ndihmojnë pa ngurrim, sepse pa ndihmën e tyre nuk do të mund ti përballonim kërkesave tona. Një valltar ose valltare i ka deri në 10 palë veshje (kostume), prandaj pa ndihmën e këtyre donatorëve nuk do ti kishim as rezultate.

**Marrin honorare anëtarët e kësaj shoqërie?**

**Shefqet Cakolli:** Nuk kanë marrë deri në

vitin 2010. Nga ky vit marrin vetëm në dasma, një honorar simbolik, vetëm sa për ti stimuluar anëtarët dhe orkestrën.

**Sa paraqitje i keni pasur në Zvicër deri më sot?**

**Shefqet Cakolli:** Është paksa vështirë të rrumbullaksohen prezentimet, por mendoj se janë diku mbi 600 paraqitje deri më tani.

**Përveç Zvicrës, jeni paraqitur edhe në shtete tjera të Evropës ku ka bashkatdhetarë?**

**Shefqet Cakolli:** Jo edhe aq, por në Gjermani kemi qenë disa herë, sepse për ne Zvicra ka qenë shumë aktive, dhe kemi pasur shumë prezentime para zviceranëve, dhe vendësve dhe nuk na ka rënë shumë të lëvizim jashtë Zvicrës.

**Sa ndihmon kjo shoqëri që të integrohemi sa më mirë në shoqërinë zvicerane?**

**Shefqet Cakolli:** Shumë ndihmon, dhe kjo ka dhënë shumë shembuj. Madje, qyteti i Winterthurit na subvencionon me një shumë parash në lokalet ku ushtrojmë, dhe kjo tregon se shoqëria ka bërë mjaft për integrimin në shoqërinë zvicerane. Ne, madje kemi qenë të parët që kemi bërë valle zvicerane me koreografinë e një zviceraneje, ku jemi prezentuar edhe me veshje, me çka kemi pasur musafirë strukturat më të larta të qytetit, si kryetaren e parlamentit, kryetarin e komunës, dhe sektorin e kulturës ku jemi përcjellur edhe nga televizioni zviceran.

**Keni marrë këshilla nga ndonjë specialist i fushës së valles, e kam fjalën në Shqipëri apo Kosovë?**

**Shefqet Cakolli:** Po, sigurisht. Pa këshillime do ta kishim edhe më të vështirë punën, prandaj ne kemi bashkëpunuar dhe jemi këshilluar me specialistë në Shqipëri, si me Ansamblin Shtetëror të Shqipërisë, me Rexhep Çelikut, Ramazan Bogdanin, me



Ansambli e Tiranës, atë të baletit, mandej në Kosovë, me Ansambli Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota”, dhe me Dilaver Kryeziun, profesorin Fahri Beqirin, si dhe me shumë ansamble dhe shoqëri tjera në trojet tona.

#### Po ju, keni vallëzuar para se të formohej SHKA “Dardania”?

**Shefqet Cakolli:** Po, kam vallëzuar, por shumë pak, në SH.K.A. “Ramiz Sadiku” në Prishtinë. Kam qenë fëmi i varfër dhe është dashur të mësoj dhe të punoj për tu shkolluar, por gjithnjë kam pasur shokët dhe shoqet rreth vetes në lëmin e kulturës, si Heset Matoshin, Fatmir Makollin, Shkurten, Shyhreten, Bege Gashin, e shumë e shumë figura tjera, që tani nuk dua ti përmend, se kam frikë se mos, pa dashje, po e harroj ndonjërin apo ndonjërin, sepse lista është e gjatë.

#### Zakonisht, në shoqëritë shqiptare që veprojnë në diasporë, janë të inkadruar edhe familjarë, psh, një çift dhe me të edhe fëmijët e tyre. A ndodhë edhe me ju kështu, që në SHKA “Dardania” të keni ndonjë pjesëtarë të familjes suaj?

**Shefqet Cakolli:** Po, fëmijët e mi, Albulena që tani është koreografe, Arbnorja dhe Samiri janë rritur së bashku me vallet dhe këngët në shoqërinë tonë, dhe tani janë vallëtarë të devotshëm, kurse gruaja herë pas here, e kohë pas kohe, sidomos nëpër festivale dhe koncerte të rëndësishme, me këngët e saja të vajzërisë me defa.

#### VULLNETI I MPOSHTË TË GJITHA

#### Është e vështirë të punohet me të rinjtë që po edukohen në Zvicër?

**Shefqet Cakolli:** Thënë sinqerisht nuk është edhe lehtë, por vullneti i mposhtë të gjitha, dhe synimi im është që të rinjtë të edukohen dhe rriten në frymën kombëtare, dhe të ruajnë identitetin e vet përmes këngës, valles dhe traditave tona.

#### Përveç grupit të vallëtarëve, keni edhe grupin folklorik. Sa këngëtarë dhe sa instrumentistë në përgjithësi ka SHKA “Dardania”?

**Shefqet Cakolli:** Ne, në fakt, edhe kemi startuar me orkestër, siç e ceka më lart, numri i këngëtarëve dhe instrumentistëve ka lëvizur gjithnjë. Nga orkestra kanë dalur edhe këngëtarë e këngëtare me emër. Numri është sjellë nga 8-15 veta, e për momentin jemi mbi 15 veta, me 6 këngëtarë e këngëtare, e në veçanti kthesat që ka bërë Ruzhdi Hajrizi me orkestrën në tërësi.

orkestra që ka ekzistuar gjithnjë, me veglat që i posedojmë duke filluar nga çiftelia, sharkia, fyellat, kavallat, lodrat, meshnicat, okarina, violina, harmonika, defat, e çka është më kryesorja ne i kemi bërë dhe i bëjmë vallet ‘live’, por edhe kemi mbi 10 valle tonat, që vetë i kemi punuar. Kuptohet, ne kemi edhe valle të përpunuara, por te ne mbizotëron folklori i pastër, duke u bazuar vetëm me burimoren.

#### Keni edhe humoristë në sofrën e SHKA “Dardania”?

**Shefqet Cakolli:** Po, kemi edhe humoristë dhe pjesë dramaturgjike-skenike në kuadër të shoqërisë, por kohëve të fundit bashkëpunojmë shumë me grupin teatral “Aktrimi” dhe na ka rënë shumë mirë, sepse po funksionon për mrekulli kombinimi me ne, duke ju dhënë anëtarët tanë në dispozicion në role të ndryshme skenike, varësisht prej momentit. Ne mbahemi edhe vetë, pa ndihmën e askujt, sepse te ne funksionojnë të gjitha zhanret e jetës kulturore, mandej moderimi, zërimi, teknika, xhirimet dhe gjithçka që i përket një koncerti.

#### Bashkëpunoni me SHKA-të tjera që janë në Zvicër?

**Shefqet Cakolli:** Tju them sinqerisht, bashkëpunojmë, por jo me të gjitha shoqëritë, sepse mentaliteti i shqiptarëve është i tillë, dhe ne e patëm një unifikim të 9 subjekteve kulturore me emrin ETNIKA, por nuk pati jetë të gjatë. Ajo zgjati vetëm tri vite, ku mua më zgjodhën kryetar të saj dhe pas tri vitesh u tërhoqën nga ky bashkim dhe në fund mbetëm vetëm tri subjekte, që nuk dua më shumë të them lidhur me këtë. Një shoqëri që arrinë suksese pak më të mira, tjetra e ka zili, dhe nuk do më bashkëpunim, prandaj ne mund ta mashtrujmë veten se bashkëpunojmë. E vërteta është ndryshe, na ka ndodhur që të bojkotohemi nëpër koncerte të ndryshme, vetëm pse kemi shkuar në qytetin e tyre të japin koncert, bile edhe hu-



#### TE NE MBIZOTËRON FOLKLORI I PASTËR

#### Me çka dalloheni nga SHKA-të tjera që veprojnë në Zvicër?

**Shefqet Cakolli:** Dallohem me shumë gjëra. Ne kemi një statut, një rreullore, kemi një kryesi, strukturat dhe klerarkinë e ekzekutivit. Mandej, ne dallohem edhe nga

manitar, e mos të flasim për të tjerat. Për atë arsye, ne krenohemi që jemi të pavarur dhe i kemi të gjitha mundësitë teknike dhe njerëzore që të funksionojmë pa asnjë ndihmë nga jashtë. Natyrisht, se ne ju jemi mirënjohës gjithë atyre, që në faza të ndryshme, na kanë ndihmuar.

**Ju ka ndodhur që një i ri apo e re shqiptare ka dashur të jetë pjesë e SHKA "Dardania" dhe prindërit nuk e kanë lejuar të vijë?**

**Shefqet Cakolli:** Po, na ka ndodhur. Megjithatë, më vonë ai prind është pendur, sa që fëmija i vet i ka dalë prej shtëpie, dhe me këtë vetem se e ka dëmtuar veten dhe fëmijën e vet.

**Merrni ndonjë vërejtje nga të rinjtë dhe të rejat e SH.K.A. "Dardania"?**

**Shefqet Cakolli:** Të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e të rinjve i marr me shumë kënaqësi dhe mundohem të përmirësohem dhe t'i përshtatem kushteve dhe ankesave, por thënë sinqerisht, nuk kam vërejtje serioze nga askush. Nganjëherë më vijnë vërejtje vetëm nga prindërit, p.sh. për të intervenuar te sistemimi i vendeve në valle, por fatkeqësisht ne nuk i marrim për bazë këto vërejtje, sepse kjo punë na takon neve, dhe jo prindërve.

**Sa herë në muaj ushtroni?**

**Shefqet Cakolli:** Ne ushtrojmë dy ditë radhazi, që i bie 8 herë në muaj.

**Për cilat valle mendoni se jeni më të mirë se të tjerët?**

**Shefqet Cakolli:** Për vallet që i punojmë vet dhe nuk janë të kopjuara, por edhe për vallet me surla e lodra që rrallë kush i ka të kompletuara. Muzikën tonë burimore me orkestrën e cila po punon me shumë vullnet. Këtu do ta kisha veçuar Hamit Shillovën, që është një mjeshtër i rrallë i instrumenteve frymore.

**Shpesh, në skenë, kur jeni paraqitur është dukur nga karrikja e spektatorit se po shohim një film, sepse keni një llojlojshmëri lojërash në skenë me motive të bukura që i ka kultura jonë e lashtë.**

**Shefqet Cakolli:** Po, ne duhet që herë pas here ti rikujtojmë përmes skenës ritet dhe doket tona, që dita ditës po shuhen. Duke e kuptuar edhe kohën, shumë nga të rinjtë nuk i dinë këto lojëra, dhe ata nga kureshtja për të mësuar diçka nga e kaluara, i luajnë shumë mirë ato inskenime që ne i parashoim dhe i përpunojmë për masën e gjerë. Pjesëmarrja jonë në festivalin e Bernit më 1996, ku kemi zënë vendin e parë me këngën e Yllka Zuzakut, mandej festivalin e Lozanës vitin e kaluar, sigurisht se masa i ka të freskëta paraqitjet tona.

**Cila është fjala më e këndshme që ua ka thënë ndonjë zvicran, me të parë paraqitjen e SHKA "Dardania"?**

**Shefqet Cakolli:** Nëse mund ta përkthej mirë është: "Nuk e paskam ditë se shqiptarët



## Kush është Shefqet Cakolli?

*Jam lindur më 27.09.1962 në fshatin Krilevë, Komuna e Kamenicës. Shkollën fillore e kam kryer në vendlindje, mandej pjesën tjetër në Strezoc, shkollën e mesme ekonomike në gjimnazin e Kamenicës, 1979/80. Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës dhe jam ekonomist i diplomuar në vitin 1987/88. I përndjekur politikisht nga regjimi i atëhershëm, i burgosur në burgun e Gjilanit si i mitur, në vitet e '70-ta, për veprimtari armiqësore dhe propagandistike, ku më janë konfiskuar një mori shkrimesh të pabotura, pas lufte kam botuar dy libra me poezi: "Dramë e Krisur" në vitin 2000 dhe "Lot i thyer" në vitin 2002 në Prishtinë. Në mërgim kam ardhë për herë të parë në verën e vitit 1983, edhe atë në Zvicër dhe që nga atëherë jam lidhur me lëvizjet e ilegalitetit në mërgim dhe jam marrë me shkrime. Në vitet e revolucionit dhe lëvizjes demokratike 1989-'90 jam kyçur në rrjedhat e asaj kohe dhe i kam shërbyer vetëm kombit, duke i anëtarësuar në LDK-në e atëherëshme njerëz që sot janë në krye të saj. Në Zvicër kam qenë anëtar i paritetit të kombeve të qytetit të Winterthurit, tri mandate. Më vonë jam zgjedhur nënkryetar i këshillit për të huajt për dy mandate, po ashtu, pranë qytetit të Winterthurit, kam udhëheq komisionin e kulturës për dy mandate (8) vite. Kryetar i nëndegës së LDK-së 5 vite, mandej kryetar i komisionit të emergjencës në kohën e luftës 1998/99, dhe kryetar i SH.K.A "DARDANIA" që pas themelimit. Iniciator dhe udhëheqës i formimit të 11 paraleleve të mësimin në gjuhën shqipe që edhe sot funksionojnë shumica prej tyre. Vallen dhe muzikën e kamë pasion dhe koreografitë i bëj së bashku me Albulenën, vajzën time. Kryetar i BSHKSHZ "ETNIKA", tri vite ku ka pasur nën obrellën e vet 9 subjekte kulturore në pjesën gjermanofolëse. Redaktor i Radios "Zëri Ynë" në gjuhën shqipe, në valët e radios Stadtfilter në Winterthur, e cila ekziston që tri vite, dhe vazhdon të ekzistojë. Jam i martuar me gruan time juriste dhe kemi tre fëmijë: Albulenën (18), Arbnorën (16) dhe Samirin (12) me banim të përkohshëm në Winterthur të Zvicrës. Kam një firmë të vogël me të cilën mbijetoj, sepse për mua nuk ka rëndësi profiti. Kohën më të madhe e kaloj në aktivitetet të shoqërisë dhe aktivitetet tjera.*

kanë kaq kulturë të mirëfilltë" ose " Ju paskeni vlerë ari" apo "Bravo ju qoftë", etj. Ka ndodhur që edhe kroatët e popuj të tjerë, që na kanë urrear prezentimin, kur kemi dalur në të njëjtën mbrëmje.

**Keni marrë pjesë nëpër gara edhe jashtë Zvicrës. A mund të na numëroni në cilat qytete shqiptare jeni prezentuar?**

**Shefqet Cakolli:** Po, kemi marrë pjesë shumë here si vëzhgues dhe grumbullues të folklorit tonë burimor, si në festivalin e Gjirokastrës në vitin 2009, mandej festivalin "Hasi Jehon", në Gjonaj dhe festivalin "Lulëkuqet e Prillit" në Dardanë, ish-Kamenicë. Këtë vit, pikërisht në prill dhe maj të këtij viti kemi marrë pjesë në këto dy festivale

që i ceka më lart dhe ato kishin karakter garues. Ishte një kënaqësi për ne dhe gjithë anëtarët tanë.

**NË FESTIVALIN "HASI JEHON" 2012, I CILI U MBAJT PARA PAK DITËSH, MORËM VENDIN E PARË DHE ÇMIMIN "MALËSORI"**

**Jeni nderuar me ndonjë shpërblim, qoftë në diasporë apo edhe në Shqipëri e Kosovë?**

**Shefqet Cakolli:** Po, jemi nderuar nga shumë shoqëri simotra këtu, e në Kosovë. Veç kësaj, kemi marrë mirënjohje nga Ambasada e Kosovës në Zvicër, nga Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe valleve "Shota" në Kosovë, por

kulminacionin tonë e kemi arritur tani në festivalin “Hasi Jehon” 2012, i cili u mbajt në maj të këtij viti, ku e morëm vendin e parë dhe çmimin “Malësori”. Kurse, po në këtë festival, morëm edhe çmimin për veshjen më të dalluar të festivalit. Mandej kemi marrë edhe dy çmime në festivalin “Lulëkuqet e Prillit” në Dardanë, ku kemi marrë çmimin e tekstit dhe këngës më të mirë, natyrisht edhe çmimin e veshjes më të dalluar e cila ishte meritë e përzgjedhjes sonë koreografike. Kemi marrë, po ashtu, edhe mirënjohje dhe falenderime nga këto dy festivale për pjesëmarrjen tonë.

**Në SHKA “Dardania” më shumë ka të rinj nga Kosova apo nga Maqedonia e Kosova Lindore?**

**Shefqet Cakolli:** Në SH.K.A “DARDANIA” ka anëtarë nga të gjitha trojet tona shqiptare. Pjesa më e madhe është nga Kosova, malësia (e Karadakut dhe Gollakut) mandej Prishtina, Gjilani, Kamenica, Dukagjini, Prizreni, Podujeva, Gjakova, Peja, Klina, Drenica, Kosova Lindore, (Medvegja, Bujanoci dhe Presheva) dhe Maqedonia, (Gostivar, Shkup, Tetovë), por kemi pasur edhe zvicranë që kanë ushtruar me ne një kohë të gjatë. Ata vijnë dhe shkojnë shpejt, sepse nuk mund ti përballojnë kushteve tona.

**I frikësoheni faktit se në SHKA “Dardania” mund të mos afrohen më të rinj, kur dihet se keni edhe moshatarë?**

**Shefqet Cakolli:** Apbolutisht jo. Te ne vijnë shumë të rinj dhe ne nuk kemi hapësirë për ti pranuar të gjithë ata që lajmërohen. E kemi shumë mirë të rregulluar strukturën dhe orarin e ushtrimeve, kështu që rinia nuk ka shumë kontakt me të moshuarit. Përkundrazi, rinia jonë ka shumë respekt për të moshuarit, sepse ne edukojmë breza dhe traditën e të nderuarit të më të moshuarve.

**Nëse një i ri apo e re dëshiron të jetë pjesë e SHKA “DARDANIA”, ku duhet të lajmërohet?**

**Shefqet Cakolli:** Shumë lehtë, hyn në internet dhe shtypë: [www.dardania95.ch](http://www.dardania95.ch), mandej i keni të gjitha mundësitë e lidhjes me ne, edhe përmes facebook-ut edhe përmes Youtube, dhe të gjitha informatat tjera së bashku me formularin e anëtarësimit. Në kuadër të SH.K.A. “DARDANIA” ekziston edhe radio “Zëri Ynë” në gjuhën shqipe, e cila emetohet të martëve nga ora 17:00 deri 18:00, ku me ne lidhen shumë dëgjues të radios sonë në



gjuhën shqipe në valët e Radiostadtfilter të Winterthurit.

**Prisni ditë më të mira, kur dihet se e kemi edhe Ministrinë e Diasporës?**

**Shefqet Cakolli:** Po të na humbasin edhe shpresat, s’e besoj dot se kthehemi në atdhe, e kam fjalën për gjeneratat që po vijnë. Përndryshe, Ministria e Diasporës nuk mendoj se do të na zgjidhë preokupimet tona, kështu si po duket jo, e nëse Qeveria ndërron kahjen, ndoshta. Nuk varet vetëm prej Ministrisë së Diasporës. Unë mendoj se kjo ministri u krijua sa për ta zbutur pak diasporën, sepse vetë buxheti tregon se sa serioze është kjo qeveri ndaj diasporës.

**A po i mungojnë diasporës sonë, e konkretisht asaj në Zvicër, manifestimet e mirëfillta?**

**Shefqet Cakolli:** Manifestimet nuk do të thoja se po i mungojnë, sepse Zvicra në këtë drejtim është shumë e organizuar sa i përket manifestimeve, por mungon koordinimi dhe mbështetja së paku morale, e pse jo edhe financiare. Duke e ditur se të gjitha shoqëritë jetojnë dhe veprojnë në baza vullnetare. Mandej, pse mos të organizohen manifestime qendrore në kuadër të shtetit?! Me pak investime dhe me të njëjtin kualitet, nuk ka nevojë të investohen aq shumë mjete për ti sjellë artistët nga Kosova.

**Sa jeni ndarë të kënaqur me disa koncerte që i keni pasur në Zvicër?**

**Shefqet Cakolli:** Ne, koncerte në Zvicër mbajmë prej se ekzistojmë, dhe nuk ka ndodhë asnjëherë në historinë tonë që ju kemi kërkuar hyrje për shërbimet tona në manifestime kombëtare dhe nacionale. Të gjitha i kemi mbajtur me kontribut vullnetar dhe me sakrificat e anëtarëve tanë të kryesisë dhe nuk kemi kursyer asgjë për ti

kënaqur dëshirat e popullit tonë të vuajtur. Duke e marrë për bazë edhe interesimin që kanë treguar me pjesëmarrjen e tyre të madhe nëpër sallat e rezervuara. Nëse i referoheni edhe koncerteve humanitare që kemi pasur kohëve të fundit, e duke mos i lënë anash as manifestimet kombëtare, nuk jemi ndarë edhe aq mirë. Marrë për bazë fjalën që thashë më lartë se na kanë bojkotuar, pikërisht shoqëritë simotra, dhe nuk na kanë përkrahur as me pjesëmarrje as me ndihma, por kanë sabotuar me të madhe për mospjesëmarrje në koncertet tona. Por, vullneti, ndihma edhe e Zotit, si dhe dëshira që ky aksion të përfundojë sa më mirë, ia kemi arritur qëllimit dhe ne tani më ia kemi ndërtuar një shtëpi një skamnori.

**Përveç aktiviteteve tuaja kulturore, jeni marrë edhe me bëmirësi. Ku keni ndihmuar dhe a mund të dimë se cila është shuma në tërësi që SHKA “Dardania” ka ndarë në trevat shqiptare?**

**Shefqet Cakolli:** Po, ne kemi organizuar një aksion humanitar për skamnorët në Kosovë, dhe e kemi pagëzuar me moton: “Duke shijuar këngësinë tuaj shpirtërore, ju ndihmoni një familje skanmore” dhe nga katër koncertet që kemi mbajtur në Winterhur (ZH), Einsiedeln (SZ), Romanshorn (TG) dhe Weesen (GL) kemi arritur që ti grumbullojmë gjithsej 17,594.00 Fr., dhe 450 ! . Kup-tohet, duke i falenderuar të gjithë donatorët që kanë kontribuar në këtë aksion. Kërkoj falje që nuk mund ti cek të gjithë kësaj here. Këtu vlenë të theksohet se ‘Dardanisë’ i kanë kushtuar sallat dhe shpenzimet tjera në buxhetin e saj, që ka investuar mjete të gatshme në vlerë prej 3,200.00 Fr. dhe shpenzime tjera të rrugës që i kam bërë vetë unë, deri sa e kemi përzgjedhur dhe sistemuar familjen e Shaban Spahiut nga Sedllari i Kamenicës. Ai këtë shtëpi e gëzon pikërisht nga 2 maji në praninë e 80 anëtarëve që gëzimin e ndajtëm së bashku me këtë familje përfituese të këtij aksioni bëmirës.

**Ndjeheni i lodhur nga angazhimi juaj?**

**Shefqet Cakolli:** Aspak, mua koha prej 24 orëve nuk më del për kontributin në shoqëri dhe nuk e humbas asnjë orë kot së koti pa u ulur për të punuar diçka për ‘Dardaninë’ dhe çështjen kombëtare. Fëmijët dhe gjithë anëtarët e shoqërisë i konsideroj si fëmijët e mij, si diçka shumë të rëndësishëm për mua, dhe për ta sakrifikohe me mëdyshe, edhe kur





më lodhin unë mbaj qëndrim sikur nuk jam lodhur.

### Jeni penduar për këto aktivitete, sepse shumë kohë keni harxhuar?

**Shefqet Cakolli:** Jo aspak, përkundrazi, unë për veti jam marrë edhe me aktivitete të ilegalitetit. Qysh në vitet e '70-'80 jam burgosur politikisht. I jam përkushtuar më shumë çështjes kombëtare se sa vetes dhe familjes dhe tani vështirë e kam ta ndryshoj kahjen. Kam mbetur me idealet e mia që ende nuk më janë ralizuar dhe sikur këtu po e gjej prehjen time me këta fëmijë me të cilët po punoj dhe kjo mi mbanë shpresat dhe ma mbyhtë zhgënjimin që kam për shumë çështje. Për mua, kënaqësia më e madhe është kur kam arritur ta mësoj një fëmijë të flasë, të ecë dhe të vallëzojë shqip. Shpërblimi më i merituar është kënaqësia e prindit duke e shikuar fëmijën e vet dhe duartrokjetet për ta.

### A është i mundshëm integrimi edhe në skenën e teatrit, duke ruajtur kulturën tonë dhe duke respektuar të tjerat?

**Shefqet Cakolli:** Patjetër se është i mundur. Ai duhet të kultivohet te brezat që po vijnë dhe përmes këmbimeve dhe respektimit të një kulture tjetër, je më i vlefshëm, gjithnjë duke e ruajtur kulturën tënde të lashtë. Ne kemi vërtetë çka të ruajmë, sepse jemi një popull i lashtë dhe kemi kaluar nëpër shumë robëri të ndryshme, kemi ruajtur trashëgiminë tonë të lashtë.

### Keni marrë pjesë nëpër dasma që janë mbajtur në Zvicër?

**Shefqet Cakolli:** Mund të them lirisht se jemi ndër të parët që kemi sjellë dhe mbjellë frymën e dasmave në Zvicër, mandej janë përhapur edhe te shoqëritë tjera. Kur ne kemi filluar ta mbjellim këtë frymë, dikush na ka përqeshë, duke na quajtur edhe të prapambetur me surla e lodra, sepse në atë kohë dasmat bëheshin me sinta dhe këngëtarë të çoroditur me muzika të përziera rome, turke, bullgare. Tani, në fakt, nuk kemi kapacitet ndaj kërkesave që na bëhen për dasmat në Zvicër.

### Na thoni drejt, a i kanë ndihmuar këto aktivitete edhe njohjeve të reja mes të rinjve dhe më pastaj janë martuar?

**Shefqet Cakolli:** Po, si jo, i kanë ndihmuar edhe shumë bile. Nuk ka javë apo vikend që të rinjtë tanë nuk takohen në ahengje dhe mbëmje rinore në rrethe të ngushta, por gjithnjë të kordinuara, natyrisht se te ne janë njoftuar dhe martuar edhe dy çifte të cilët më nuk janë në shoqërinë tonë.

### 95% E ANËTARËVE JANË SHTETAS ZVICRAN

#### Në çka mendoni se duhet të investojë sa më shpejt Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës?

**Shefqet Cakolli:** Mendoj që duhet tu ofrojë shoqërive, shkollave dhe shoqatave të ndryshme një kulm mbi kokë, një qendër dhe të bëjë infrastrukturën ligjore, kush dhe çka duhet të bëjë, jo të lihet nën mëshirën e secilit të bëjë çka ti teket, dhe të përfitojë në emër të shqiptarëve, për interesa të veta. Kështu po ndodhë dhe me shoqëritë apo shoqatat e mirëfillëta dhe serioze po mbesin nën hijen e matrapazëve dhe përfituesve të fondeve të lejuar të shtetit tonë, por më shumë të shtetit të Zvicrës.

#### Në SHKA "DARDANIA", të rinjtë dhe te rejtat flasin gjermanisht apo shqip? Na thoni drejt edhe pse shpesh, e drejta dhemb, por nuk mundemi ti ikim?

**Shefqet Cakolli:** Ne, gjatë ligjeratave, spjegimeve dhe njoftimeve komunikojmë vetëm shqip, ka ndodhur që shumë nga fëmijët janë mësuar të flasin sepse vërtetë ne komunikojmë vetëm shqip. Kjo neve na ka penguar edhe në realizimin e shumë projekteve që i kemi paraqitur para organeve zvicerane, sepse na kanë akuzuar se flasin vetëm shqip, edhe pse 95% e anëtarëve janë shtetas zviceranë.

#### Po nëpër spektakle apo manifestime të ndryshme zvicerane, keni marrë pjesë?

**Shefqet Cakolli:** Sa për ilustrim, po ju cek festën e fundit që patëm në qytetin e Zürichut, Laubeg, mandej në qytetin e Watwillit dhe shumë e shumë manifestime tjera që tani më nuk ka mundësi ti përmendi të gjitha.

#### SHKA "DARDANIA", me gjithë këtë veprimtari, ka ndonjë album me video apo ndonjë libër monografik?

**Shefqet Cakolli:** Po, sigurisht se ka. Një CD me këngë dhe valle, dhe një DVD, e cila përfshinë periudhën deri në 15 vjetorin e saj më 2009, ku janë të xhiruara shumë valle dhe

këngë të interpertuara nga SH.K.A. "DARDANIA". Mandej kemi edhe gazetën periodike e cila botohet kohë pas kohe, dhe tani është në përpunim e sipër numri i radhës, e cila së shpejti do të botohet. Kemi, po ashtu, dy faqe të internetit, portalin social, facebook, mandej Youtube dhe xhirimet tona origjinale gjatë aktiviteteve tona që nga themelimi e deri më sot.

#### E keni ndërmend që ta bëni ndonjë libër monografik për historinë e SHKA "Dardania"?

**Shefqet Cakolli:** Nëse më jep Zoti jetë, siç thonë pleqtë te ne, po. Patjetër, sepse unë personalisht merrem me shkrime nëpër gazeta, mandej unë i kam botuar edhe dy libra me poezi, dhe këtë obligim po ia lë vetit kur të plakem, edhe pse vetja po më duket shumë i ri (qeshet).

#### Në skenë, kuptohet se më shumë jeni paraqitur me flamurin kombëtar kuq e zi. A jeni mësuar me flamurin e Kosovës?

**Shefqet Cakolli:** Singerisht tju them, në mesin tonë janë nga të gjitha trojet shqiptare dhe flamurin kombëtar e kemi si simbol që identifikohemi më së shumti, prandaj flamuri i imponuar i Kosovës, vetëm kur skemi kah t'ia mbajmë, se përndryshe nuk e preferojmë fare.

#### Në fund të këtij bashkëbisedimi, duke kujtuar se në një të ardhme të shpejtë, do të kemi përsëri të flasim edhe për tema tjera, që nuk kemi mundur ti bashkëbisedojmë gjatë kësaj interviste, do të na interesonte të kemi një mendim tuajin se a është harruar diaspora shqiptare nga atdheu?

**Shefqet Cakolli:** Jo që është harruar, por është edhe duke u përbuzur, por më mbanë shpresa se me formimin e Ministrisë së Diasporës, do të ndryshojnë gjërat. Ata poshtë duhet të mendojnë për popullin e vet, që e ka ndihmuar me vite, dhe atyre tani ju duhet një respekt.

#### Pyetja e fundit, a i ke thënë vetes se do të kthehesh përgjithmonë në atdhe?

**Shefqet Cakolli:** Menjëherë pas lufte jam kthyer në atdhe, por nuk munda, sepse pash gjëra të pahijshme dhe u zhgënjeva nga shumë veprime të disa njerëzve atje. Sidoqoftë, në fund të fundit, unë jam shumë i lidhur për atdheun dhe kjo më mbanë gjallë se një ditë do ta shijoj atë liri, pas shumë sakrificave që bëri diaspora dhe populli ynë.